



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:161276
Datë: 04.10.2024
Numri i dokumentit: 06252599

K.DH.SH.II.nr.688/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “K.N.T.SH. Teuta - M” SH.P.K., me NUI: 819504581, me seli në rr. “Arbëria” Nr. 106, në Gjilan, i përfaqësuar nga V.H., avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Kompania Rajonale Ujësjetllësit Hidromorava” SH.A., me NUI: 811339979, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1142/23, e datës 30.11.2023, me datën 02.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “Kompania Rajonale Ujësjetllësit Hidromorava” SH.A., me seli në Prishtinë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1142/23, e datës 30.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1142/23, e datës 30.11.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Kompania Rajonale Ujësjetllësit Hidromorava” SH.A., me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrorit përmbartimor P.nr.172/23 të datës 07.07.2023 të Përmbartuesit Privat Eset Murati.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes se dispozitave të procedurës përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka theksuar se Urdhri Përmbartimor është lëshuar në përputhje të plotë me titullin përmbartimor të shpallur dhe të ekzekutueshëm me vendim të gjykatës të formës së prerë si dhe vendimi i goditur nuk përmban asnjë shkelje ligjore të pretenduar të debitorit, andaj gjykatës së shkallës së dytë i ka propozuar që ta refuzoj ankesën e debitorit si të pabazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat Eset Murati, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “K.N.T.SH. Teuta - M” SH.P.K., me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv - Vendimit të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës, Nr. Arb/01/2022 të datës 16.12.2022, i shpallur i ekzekutueshëm me Aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.2865/22 të datës 22.06.2023, ka nxjerr urdhrin P.nr.172/23 me datën 07.07.2023, me të cilin është detyruar debitori “Kompania Rajonale Ujësjellësit Hidromorava” SH.A., me seli në Prishtinë, që t’ia paguajë kreditorit shumën prej 77,884.14 € në emër të punëve të kryera me kamatë prej 8% në vit e cila llogaritet nga data 09.03.2022 e deri në pagesën e plotë, shumën prej 6,884.40 € në emër të shpenzimeve të procedurës së arbitrazhit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore deri në përfundimin e saj, me ndalimin e mjeteve monetare të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit. Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor duke theksuar se vlera reale e kërkesës kryesore është në shumën prej 59,216.32€ dhe në asnjë mënyrë kamata nuk ka mundur të jetë 27,668.00 €, ashtu që kreditori pjesërisht po pasurohet pa baza juridike, ngase eksperti financiar ka gabuar në përlllogaritjen e kamatës. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet pjesërisht prapësimi i debitorit dhe sa i përket pjesës së kërkesës lidhur me kamatën e cila është llogarit gabimisht të anulohet urdhri përmbartimor dhe lëndën t’ia kthejë përmbartuesit privat në rivendosje.

Kreditori është njoftuar rreth prapësimin të paraqitur nga ana e debitorit me datën 21.07.2023, ndërsa përgjigjen në prapësim e ka paraqitur me datën 25.07.2023, jashtë afatit ligjor. Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 72 par. 3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se “Përgjigjet lidhur me prapësimin duhet të paraqiten me shkrim brenda afatit prej tre (3) ditësh”, të njëjtën nuk e ka shqyrtuar fare meqenëse e njëjta është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimit ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1142/23, e datës 30.11.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Kompania Rajonale Ujësjellësit Hidromorava” SH.A., me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.172/23 të datës 07.07.2023 të Përmbaruesit Privat Eset Murati.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se dokumenti përmbarimor - Vendimi i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës, Nr. Arb/01/2022 të datës 16.12.2022, i ekzekutueshëm nga data 22.06.2023 është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së,

Gjykata e Shkallës së Dytë vlerëson se Vendimi i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës, Nr. Arb/01/2022 të datës 16.12.2022, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 par. 1, pika 1.6, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“vendimet dhe marrëveshjet përmbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i pambarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës, Nr. Arb/01/2022 të datës 16.12.2022, është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se *“ Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri ”*, Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim i cili është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim. Arsye këto nga te cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë te paargumentuara dhe si te tilla mbeten vetëm ne natyrën deklarative , te pambështetura ne prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 te LPP.

Gjykata mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit në lidhje me llogaritjen e gabuar të kamatës, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara, pasi që të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.688/24, me datë 02.10.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami